



Ky projekt është
financuar nga BE

Sistemi I Integruar I Menaxhimit Të Mbetjeve Të Ngurta

Përshkrimi i Projektit

Të dhëna për projektin

Emri i Projektit: "Asistencë Teknike për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për dy Bashkitë e Përzgjedhura të Shqipërisë"

Përfituesi: Ministria e Mjedisit të Republikës së Shqipërisë

Financimi: Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Kontraktor: Eptisa Servicios de Ingenieria Dega në Shqipëri

Data e fillimit: 27 Mars 2017

Data e përfundimit: 26 Shtator 2019

Fazat e projektit: 2 (3 muaj faza Fillestare / 27 muaj faza e Zbatimit)

Zyra e projektit: Rruga Ibrahim Rugova Ndërtesa 28; Kati 5; Nr. 19; 1000 Tiranë; Shqipëri; Tel: +355 (0) 67 39 23 322; Email: mshiqerukaj@eptisa.com; URL: www.imswm.al; www.eptisa.com; www.eptisasee.com;

Zyra e përfituesit: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23; 1001 Tirana; Albania; Tel: +355 (0) 4 222 4537; URL: www.mjedisi.gov.al;

Zyra e BE: ABA Business Centre; Rr. Papa Gjon Pali II; 1001 Tirana; Albania; Tel: + 355 (0) 422 281 07; URL: https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en;

- Trajtimi më i mirë i mbetjeve ndikon në ruajtjen e natyrës dhe shëndetit të njeriut;
- Infrastruktura e përmirësuar do të rrisë mundësitë e reja për prosperitetin ekonomik të vendit;
- Miratimi dhe zbatimi i projektit do të rrisë shanset për krijimin e vendeve të reja të punës;
- Njohuritë shqipëtare ndihmohen nga komuniteti dhe ekspertët ndërkombëtarë për arritjen e një qëllimi të përbashkët, hyrjen në Bashkimin Evropian duke zbatuar dhe ndjekur "acquis";

PREZANTIM:

Projekti "Asistencë Teknike për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për dy Bashkitë e Përzgjedhura të Shqipërisë", i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Eptisa, për Ministrinë e Mjedisit, midis objektivave të veçanta teknike, ka rritjen e vetëdijes publike, e mbështetur kjo me ngritjen e kapaciteteve për vetë faktin se sa i rëndësishëm është menaxhimi i duhur i mbetjeve për ruajtjen e mjedisit, shëndetit publik dhe në fund për një standard më të lartë jetese të popullsisë së Shqipërisë. Për të arritur këtë qëllim, është e rëndësishme që institucionet kompetente të zbatojnë politikën dhe teknologjinë e duhur të menaxhimit të mbetjeve dhe që publiku i gjerë të angazhohet në qëndrime korrekte gjatë tërë procesit të planifikimit dhe zbatimit.

Projekti do të sigurojë që autoriteti Shqipëtar do të marrë ndihmën më të

mirë të mundshme teknike në nivel qendror dhe lokal, i cili siguron një rrugë drejt BE-së me theks të veçantë në mbetjet bashkiake, duke ndjekur parimet kryesore operacionale dhe organizative për menaxhimin e mbetjeve.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM:

Për të mbështetur Qeverinë e Shqipërisë (Ministrinë e Mjedisit), në përpjekjet e tyre drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të vendit nëpërmjet kushteve mjedisore të përmirësuar dhe kërkesave të ndryshimit klimatik duke bërë të mundur që Institucionet Qeveritare të zhvillo-



Sistemi I Integruar I Menaxhimit Të Mbetjeve Të Ngurta
Për Dy Bashkitë të Përzgjedhura të Shqipërisë
www.imswm.al

jnë dhe zbatojnë legjislacionin e ndryshuar mjedisor dhe klimatik sipas standarteve të BE-së;

Një objektiv i mëtejshëm gjatë fazës së zbatimit janë identifikimi i teknologjisë më të përshtatshme (BAT / BATNEEC), të përbalueshme financiarisht, të realizueshme ekonomikisht, me natyrë mjedisore dhe zgjidhje të pranueshme politike me fokus në faktorët ekonomikë duke arritur ndikime pozitive ekologjike për mirëqënien e popullatës së Republikës së Shqipërisë në një prespektivë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

QËLLIMI I PROJEKTIT ËSHTË:

Rishikimi i gjëndjes bazë të sektorit të mbetjeve, duke përfshirë një hartë të nevojave dhe infrastrukturës ekzistuese në nivel lokal. Studimet e fizibilitetit, duke përfshirë hartimet paraprake, të objekteve moderne të mbetjeve për Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe hartimin e planeve lokale të mbetjeve, në dy Bashkitë e përzgjedhura. Përzgjedhja është bazuar në hartën e nevojave dhe infrastrukturave, dhe merr parasysh aktivitetet e donatorëve dhe partnerëve të tjerë.

Asistencë Teknike për mbështetjen e dy Bashkive të përzgjedhura në zbatimin e planeve lokale të mbetjeve, duke përfshirë planifikimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe veprimet pilot për ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

AKTORËT KRYESORE TË PROJEKTIT:

- Ministria e Mjedisit;
- Ministrinë e Linjës (Transportit dhe Infrastrukturës, Zhvillimit Urban, Qeverisja vendore, Integrimi, Financa, etj.);
- Shoqata e Bashkive të Shqipërisë;
- Dhoma e tregëtisë dhe shoqatat private si dhe shoqëritë që punojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie;
- OJQ-të;
- Donatorët dhe IFN;
- Këshillat rajonale;
- Bashkitë dhe ofruesit e shërbimit publik përkatës;
- Ndërmarrjet rajonale;
- Universitetet dhe qendrat arsimore;
- Institute kërkimi dhe projektimi me natyrë publike dhe private;

AKTIVITETET KRYESORE:

Përzgjedhja e dy bashkive / rajoneve bazuar në situatën ekzistuese (hartëzimi);

Zhvillimi dhe zbatimi i një plani komunikimi;

Krijimi i një pasqyre me të dhëna domethënëse që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta duke u fokusuar në mbetjet e ngurta në nivel bashkie;

Rishqyrtimi dhe / ose ripërsëritja e planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve;

Krijimi i rrjeteve të aktorëve të interesuar në nivel kombëtar dhe lokal; Identifikimi i zonave të grumbullimit të mbetjeve për të arritur qëndrueshmërinë fizibilitetin ekonomik;

Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit, duke përfshirë grumbullimin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin në nivel lokal / rajonal;


Mbështetja e zhvillimit të strukturës operationale menaxheriale të mbetjeve si pasoje e masave për ngritjen e kapaciteteve;

PËRFITUESI KRYESOR:

Popullsia e Republikës së Shqipërisë



Fletëpalosja është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Asistencë Teknike për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për dy Bashkitë e Përzgjedhura të Shqipërisë". Kjo fletëpalosje informative nuk përbën një komunikim formal dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.



ep_tisa